




Prokuroria tregon se pse ishte liruar 73 vjeçari që ditë më parë u arrestua për dhunë në familje e sot plagosi gruan



06/08/2024 15:33



Prokuroria Themelore në Prishtinë është deklaruar në lidhje me plagosjen që ndodhi sot në Bresje të Fushë-Kosovës ku e plagosur mbeti një grua.

I dyshuar në këtë rast është I.Alija, 73 vjeçar i cili ka plagosur gruan e tij e më pas të njëjtën e ka goditur disa herë radhazi në prani të djalit, 12 vjeç.

Prokuroria ka bërë të ditur se Departamenti i Përgjithshëm i kësaj prokurorie më datë 02.08.2024 në ora 17:30, ka ndaluar të pandehurin I.A, për shkak të dyshimit se i njëjti ka kryer veprën penale “Dhunë në familje” nga neni 248 të KPRK-së.

“Ju njoftojmë se më datë 04.08.2024, Prokurori i Shtetit ka ngritur Aktakuzë me kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit kundër të pandehurit I.A. Po ashtu, më datë 04.08.2024, në Gjykatën Themelore në Prishtinë – dega në Fushë Kosovës, është mbajtur shqyrtimi fillestar në këtë çështje penale, ku Prokurori i Shtetit gjatë kësaj seance, duke marrë parasysh gjendjen shëndetësore të të pandehurit si dhe faktin se i pandehuri ka edhe një adresë tjetër të vendbanimit, ka propozuar masën e arrestit shtëpiak”,thuhet në njoftim.

Tutje u tha se Gjykata ka refuzuar propozimin e Prokurorit të Shtetit për caktimin e masës së arrestit shtëpiak, ashtu që ndaj të pandehurit I.A, është caktuar masa e ndalimit për t’iu afruar vendit apo personit të caktuar.

“Ndërkaq, sot, më datë 06.08.2024, i pandehuri I.A, është arrestuar në fshatin Bresje, në Fushë Kosovë, me dyshimin për kryerjen e veprave penale “Vrasje e rëndë në tentativë” nga neni 173 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 i KPRK-së dhe “Mospërfillja e gjykatës” nga neni 393 të KPRK-së”.

Në vendin e ngjarjes ka dal Prokurori i Shtetit, me qëllim të sigurimit të provave materiale, si dhe, ka vizituar të dëmtuarën e rastit, e cila është në trajtim në SHSKUK në Prishtinë, ndërsa ndaj të pandehurit IA, ka lëshuar Aktvendim mbi ndalim.

“Prokurori i Shtetit në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, janë duke punuar intensivisht me qëllim të ndriçimit të rrethanave të cilat i kanë paraprirë kryerjes së këtyre veprave penale”,thuhet në njoftimin e prokurorisë./Lajmi.net/

Më shumë nga uebi

nativeGRAM
by LuponMedia



Artikuj të ngjashëm



August 6, 2024
Policia e Kosovës kërkon ndihmë për kapjen e Stresit



August 6, 2024
Inspektorati i Punës hap zyrën në Zveçan



August 6, 2024
Vuçiq: Kurti kërkon konflikte para zgjedhjeve në Amerikë



August 6, 2024
Tre të vdekur në Shqipëri nga “Ethet e Nilit”, reagon ministria...



August 6, 2024
Krasniqi në 31 vjetorin e vdekjes së Esad Mekulit: Veprimtaria e...



August 6, 2024
Ekipi olimpik u kthye nga Parisi, Kurti: Dikur imagjinare Kosova t'ì...